



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2021:043832

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06554678

**C.nr. 140/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen kontestimore të paditësit N. N. (H.) nga Ferizaj, rr."28 Nëntori" p.nr, të cilin me autorizim e përfaqëson B. I. avokat në Gjilan, kundër të paditurit I. N. (M.) nga fshati M. i Komunës së Vitisë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me vlerë të kontestit prej 20,000 euro, jashtë seancës me datë 04.12.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësit N. N. (H.) nga Ferizaj, kundër të paditurit I. N. (M.) nga fshati M. i Komunës së Vitisë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

- Pas plotfuqishmërisë kjo lëndë do të arkivohet në arkivin e kësaj gjykate.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Me datë 08.03.2021, paditësi N. N. (H.) nga Ferizaj, përmes të autorizuarit të tij, ka ngritur padi kundër të paditurit I. N. (M.) nga M.u i Vitisë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të shitblerjes, të cilat gjenden në Zonën Kadastrale në M., për të cilat paditësi në shkresat e lëndës ka deponuar edhe Kontratën për shitblerjen e paluajtshmërisë, të lidhur me datë 22. Janar 2021, me vlerën e kontratës dhe kontestit prej 20,000 euro.

Por paditësi personalisht, me parashtresën e datës 02.12.2024, për të autorizuarit të vet me prokurë av. B. I., e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë, duke e arsyetuar tërheqjen se tanimë për këtë lëndë/çështje nuk ka më interes që ta vazhdoj procedurën në këtë çështje, andaj edhe dëshiron ta tërheqi padinë dhe e njëjta nuk dëshiron të qëndroj edhe më tej në gjykatë. Gjykata duke e respektuar vullnetin e palës paditëse, si palë aktive e konstaton tërheqjen e padisë duke u bazuar në nenin 261 paragrafi 1, 3 dhe 4 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2021:043832  
Datë: 05.12.2024  
Numri i dokumentit: 06554678

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitën e nenit 449 dhe 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA E GJYKATËS NË VITI  
C. nr.140/2021 datë, 04.12.2024

G j y q t a r i,  
Raif Fazliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK-së.